




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

### **Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit Janar 2020**



## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në shtator të vitit 2002 deri në muajin dhjetor 2014, ndërsa nga muaji janar 2015 është harmonizuar sipas konceptit ndërkombëtar dhe publikohet si Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Çmimet e konsumit kanë filluar të mblidhen në muajin maj të vitit 2002 i cili konsiderohet muaji bazë.

Nga muaj janar i vitit 2016 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) bazuar në rekomandimet e Eurostatit publikohet me vitin bazë **2015=100**. Çmimet mblidhen prej datës 10 deri 20 të muajit në 14 Komuna të Kosovës.

ASK nga muaji shtator i vitit 2002 në vazhdimësi ka publikuar në baza mujore IÇK - IHÇK dhe pesëmbëdhjetë publikime në baza vjetore (2004 - 2018).

Ky publikim përmban tabelën me Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në Kosovë në baza mujore janar 2010 – janar 2020, mesatarja vjetore 2010-2019 (2015=100), me ndryshimet mujore dhe vjetore në përqindje, paraqitja grafike, tabelën për peshat specifike, indeksin për muajin janar 2020, ndryshimet mujore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Janar 2020 / Dhjetor 2019) dhe ndryshimet vjetore të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në përqindje (Janar 2020 / Janar 2019) për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it, tabelën me çmime mesatare për disa artikuj më reprezentues dhe metodologjinë e kalkulimit të indekseve të harmonizuara të çmimeve të konsumit.

### Shpjegim për shfrytëzuesit e të dhënave

Pasi që seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK-it) në vend janë publikuar me bazë muaj Maj 2002=100 për periudhën maj 2002 - dhjetor 2015. Ndërsa nga muaji janar i vitit 2016 me rekomandimet e Eurostatit Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është kalkuluar me vitin bazë 2015=100 dhe janë të rikalkuluara me këtë bazë të gjitha seritë kohore të Indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) në vend dhe janë të publikuara me 31.05.2019 në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin vjetor të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit 2002 – 2018).

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën elektronike: E-mail [economic@rks-gov.net](mailto:economic@rks-gov.net)

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), përkatësisht Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është publikim i rregullt mujor.

Publikimin përgatitën:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit  
Ibish Asllani - Shef i Divizionit  
Raif Gashi - Zyrtar i lartë

Shkurt, 2020

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-ës  
Isa Krasniqi

## Simbolet dhe Shkurtesat

IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
COICOP	Klasifikimi i konsumit individual sipas qëllimit
ABF	Anketa e buxhetit familjar
LLK	Llogaritë Kombëtare
IHÇK	Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
:	Shifra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike – IÇK/IHÇK)
∅	Mesatare

## Përmbajtja

	Faqe
Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Janar 2020.....	5
Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje .....	6
Grafiku 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2019 (2015=100).....	9
Grafiku 2: Ndryshimet vjetore dhe mujore në përqindje të IHÇK-it .....	9
Tabela 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it.....	10
Tabela 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese .....	12
Metodologjia e IHÇK.....	13

## Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin Janar 2020

Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0,8% në muajin janar 2020. Shkalla vjetore e inflacionit e matur në muajin janar 2020 me muajin janar 2019 ishte 1,5%.

### Janar 2020 / Dhjetor 2019 0,8%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 0,8% në muajin janar 2020 krahasuar me muajin dhjetor 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: pemët (7,7%), perimet (16,6%), produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (1,5%), shërbimet ambulatorë (3,2%), shërbimet hoteliere (1,4%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,9 për qind në IHÇK-it. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupi i pijeve alkoolike (-2,2%) me një ndikim të këtij nëngrupi prej -0.1 për qind në IHÇK-it. Si dhe te disa nëngrupe, çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tjera kryesisht mbetën të pandryshuara pa ndonjë ndikim në IHÇK-it.

### Janar 2020 / Janar 2019 1,5%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë për 1,5% në muajin janar 2020 krahasuar me muajin janar 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (2,7%), mish (2,6%), pemët (12,1%), produkte të ndryshme ushqimore, kripëra, erëza etj. (3,4%), kafja, çaji dhe kakao (10,6%), ujë, pije joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (0,8%), mobilje dhe orëndi, qilimat dhe mbulesa dyshemeje të tjera (1,5%), pajisje shtëpiake (2,3%), enët, takëmet dhe mjetet e ndryshme të kuzhinës (3,5%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (2,2%), produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (2,8%), shërbimet ambulatore (5,6%), blerja e automjeteve (2,0%), përdorimi i pajisjeve për transportin personal (2,7%)-(ngritje e çmimeve të naftës dhe benzinës), shërbimet hoteliere (2,3%), shërbimet e akomodimit (6,0%), gjërat personale (2,9%), sigurimet (19,3%) - (ngritje e çmimeve të sigurimeve të automjeteve), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1,9 për qind në IHÇK-it. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet: perimet (-8,7%), energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-1,9%) - (rënie e çmimeve të druve për ngrohje), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it. Si dhe te disa nëngrupe, çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tjera kryesisht mbetën të pandryshuara pa ndonjë ndikim në IHÇK-it.

**Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje**

Viti	Muaji	Indeksi (2015 = 100)	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje	
2010	Janar	88,0	0,6	0,7	
	Shkurt	88,2	0,2	1,1	
	Mars	88,1	-0,1	0,8	
	Prill	87,2	-1,0	1,6	
	Maj	87,5	0,3	2,2	
	Qershor	87,6	0,1	2,2	
	Korrik	87,9	0,3	2,7	
	Gusht	90,5	3,0	6,0	
	Shtator	90,8	0,3	6,0	
	Tetor	91,9	1,2	6,0	
	Nëntor	92,3	0,4	6,2	
	Dhjetor	93,2	1,0	6,5	
	<b>Mesatarja vjetore 2010</b>		<b>89,4</b>	<b>:</b>	<b>3,5</b>
	2011	Janar	94,5	1,4	7,4
Shkurt		96,5	2,1	9,4	
Mars		97,6	1,1	10,8	
Prill		96,5	-1,1	10,7	
Maj		96,5	0,0	10,3	
Qershor		95,7	-0,8	9,2	
Korrik		95,2	-0,5	8,3	
Gusht		95,3	0,1	5,3	
Shtator		95,1	-0,2	4,7	
Tetor		96,2	1,2	4,7	
Nëntor		96,2	0,0	4,2	
Dhjetor		96,5	0,3	3,5	
<b>Mesatarja vjetore 2011</b>		<b>96,0</b>	<b>:</b>	<b>7,4</b>	
2012		Janar	97,3	0,8	3,0
	Shkurt	98,2	0,9	1,8	
	Mars	98,3	0,1	0,7	
	Prill	97,6	-0,7	1,1	
	Maj	97,6	0,0	1,1	
	Qershor	97,3	-0,3	1,7	
	Korrik	97,3	0,0	2,2	
	Gusht	98,3	1,0	3,1	
	Shtator	99,1	0,8	4,2	
	Tetor	99,9	0,8	3,8	
	Nëntor	99,5	-0,4	3,4	
	Dhjetor	100,1	0,6	3,7	
	<b>Mesatarja vjetore 2012</b>		<b>98,4</b>	<b>:</b>	<b>2,5</b>
	2013	Janar	100,7	0,6	3,5
Shkurt		100,8	0,1	2,6	
Mars		100,8	0,0	2,5	
Prill		100,0	-0,8	2,5	
Maj		99,7	-0,3	2,2	
Qershor		99,9	0,2	2,7	
Korrik		99,6	-0,3	2,4	
Gusht		99,5	-0,1	1,2	
Shtator		99,3	-0,2	0,2	
Tetor		100,1	0,8	0,2	
Nëntor		100,3	0,2	0,8	
Dhjetor		100,6	0,3	0,5	
<b>Mesatarja vjetore 2013</b>		<b>100,1</b>	<b>:</b>	<b>1,7</b>	

**Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)**


Viti	Muaj	Indeksi (2015=100)	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje
2014	Janar	100,9	0,3	0,2
	Shkurt	100,9	0,0	0,1
	Mars	101,1	0,2	0,3
	Prill	100,3	-0,8	0,3
	Maj	100,2	-0,1	0,5
	Qershor	100,3	0,1	0,4
	Korrik	100,4	0,1	0,8
	Gusht	100,4	0,0	0,9
	Shtator	100,6	0,2	1,3
	Tetor	100,7	0,1	0,6
	Nëntor	100,4	-0,3	0,1
	Dhjetor	100,2	-0,2	-0,4
		<b>Mesatarja vjetore 2014</b>	<b>100,5</b>	<b>:</b>
2015	Janar	100,3	0,1	-0,6
	Shkurt	100,6	0,3	-0,3
	Mars	100,7	0,1	-0,4
	Prill	99,9	-0,8	-0,4
	Maj	99,7	-0,1	-0,5
	Qershor	99,9	0,1	-0,4
	Korrik	99,6	-0,2	-0,8
	Gusht	99,7	0,1	-0,7
	Shtator	99,4	-0,3	-1,2
	Tetor	100,0	0,6	-0,7
	Nëntor	100,1	0,1	-0,3
	Dhjetor	100,0	0,0	-0,2
		<b>Mesatarja vjetore 2015</b>	<b>100,0</b>	<b>:</b>
2016	Janar	100,5	0,4	0,1
	Shkurt	100,7	0,2	0,0
	Mars	100,8	0,1	0,1
	Prill	99,8	-1,0	-0,1
	Maj	99,6	-0,2	-0,1
	Qershor	99,6	-0,1	-0,3
	Korrik	99,6	0,0	0,0
	Gusht	99,8	0,2	0,0
	Shtator	99,9	0,2	0,6
	Tetor	100,9	0,9	0,9
	Nëntor	101,0	0,1	0,9
	Dhjetor	101,3	0,4	1,3
		<b>Mesatarja vjetore 2016</b>	<b>100,3</b>	<b>:</b>
2017	Janar	102,2	0,8	1,7
	Shkurt	102,3	0,2	1,7
	Mars	102,3	-0,1	1,5
	Prill	102,0	-0,3	2,2
	Maj	101,2	-0,8	1,5
	Qershor	101,5	0,3	1,9
	Korrik	101,3	-0,2	1,7
	Gusht	101,5	0,2	1,7
	Shtator	101,6	0,1	1,7
	Tetor	101,8	0,2	0,9
	Nëntor	101,8	0,1	0,9
	Dhjetor	101,8	0,0	0,5
		<b>Mesatarja vjetore 2017</b>	<b>101,8</b>	<b>:</b>

**Tabela 1: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) Janar 2010 – Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje (vazhdim)**


Viti	Muaj	Indeksi (2015=100)	Ndryshimi mujor në përqindje	Ndryshimi vjetor në përqindje	
2018	Janar	102,0	0,2	-0,2	
	Shkurt	102,3	0,3	0,0	
	Mars	102,4	0,1	0,1	
	Prill	102,4	0,0	0,4	
	Maj	102,2	-0,2	1,0	
	Qershor	102,3	0,1	0,8	
	Korrik	102,5	0,2	1,2	
	Gusht	103,0	0,4	1,5	
	Shtator	103,1	0,1	1,4	
	Tetor	103,3	0,2	1,5	
	Nëntor	103,9	0,7	2,1	
	Dhjetor	104,8	0,8	2,9	
	<b>Mesatarja vjetore 2018</b>		<b>102,8</b>	<b>:</b>	<b>1,1</b>
	2019	Janar	105,2	0,4	3,1
Shkurt		105,6	0,4	3,2	
Mars		105,7	0,1	3,3	
Prill		105,9	0,1	3,4	
Maj		105,7	-0,2	3,4	
Qershor		105,3	-0,3	3,0	
Korrik		105,2	-0,1	2,6	
Gusht		105,7	0,5	2,7	
Shtator		105,6	-0,1	2,4	
Tetor		105,5	0,0	2,2	
Nëntor		105,7	0,2	1,7	
Dhjetor		106,0	0,2	1,2	
<b>Mesatarja vjetore 2019</b>		<b>105,6</b>	<b>:</b>	<b>2,7</b>	
2020		Janar	106,8	0,8	1,5



**Grafiku 1: Indeksi i harmonizuar vjetor i çmimeve të konsumit sipas viteve 2010 - 2019 (2015=100)**



**Grafiku 2: Ndryshimet vjetore dhe mujore në përqindje të IHÇK-it**



**Tabela 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2020 në %	I - 2020 2015=100	I - 2020 XII- 2019	I - 2020 I - 2019
<b>00</b>	<b>Gjithsej IHÇK</b>	<b>1000,0</b>	<b>106,8</b>	<b>0,8</b>	<b>1,5</b>
<b>01</b>	<b>Ushqimi dhe pijet joalkoolike</b>	<b>401,2</b>	<b>110,2</b>	<b>1,9</b>	<b>1,8</b>
<b>01.1</b>	<b>Ushqimi</b>	<b>347,4</b>	<b>110,7</b>	<b>2,1</b>	<b>1,7</b>
01.1.1	Buka dhe drithërat	102,1	113,1	0,2	2,7
01.1.2	Mishi	103,7	110,0	-0,1	2,6
01.1.3	Peshqit	3,1	109,6	0,4	4,0
01.1.4	Qumështi, djathi dhe vezët	54,2	108,2	0,0	-0,2
01.1.5	Vajrat dhe yndyrnat	6,2	105,6	0,5	0,9
01.1.6	Pemët	21,7	97,8	7,7	12,1
01.1.7	Perimet	33,1	115,1	16,6	-8,7
01.1.8	Sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat	14,4	108,7	0,2	1,4
01.1.9	Prodhimet ushqimore	8,9	105,7	0,5	3,4
<b>01.2</b>	<b>Pijet joalkoolike</b>	<b>53,8</b>	<b>108,2</b>	<b>0,2</b>	<b>2,9</b>
01.2.1	Kafja, çaji dhe kakao	11,4	126,5	0,3	10,6
01.2.2	Uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet	42,4	103,4	0,2	0,8
<b>02</b>	<b>Pijet alkoolike, duhani</b>	<b>57,3</b>	<b>116,4</b>	<b>-1,0</b>	<b>-0,2</b>
02.1	Pijet alkoolike	25,4	108,8	-2,2	-1,6
02.2	Duhani	31,9	122,9	0,0	0,9
<b>03</b>	<b>Veshje dhe këpucë</b>	<b>40,7</b>	<b>103,2</b>	<b>-0,1</b>	<b>1,9</b>
03.1	Veshje	30,6	102,7	-0,2	2,4
03.2	Këpucë	10,1	104,7	0,0	0,1
<b>04</b>	<b>Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera</b>	<b>77,2</b>	<b>100,2</b>	<b>0,2</b>	<b>-1,1</b>
04.1	Pagesa aktuale për banim	5,8	97,5	0,0	0,0
04.3	Mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit	9,4	104,0	0,2	1,1
04.4	Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	10,7	98,0	0,0	0,0
04.5	Energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera	51,3	98,7	0,3	-1,9
<b>05</b>	<b>Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë</b>	<b>75,9</b>	<b>103,3</b>	<b>0,1</b>	<b>2,2</b>
05.1	Mobilje dhe orendi, qilimat dhe mbulesa dysHEMEJE të tjera	17,9	101,3	0,2	1,5
05.2	Tekstile shtëpiake	3,5	101,0	-0,1	1,3
05.3	Pajisje shtëpiake	15,4	100,1	-0,4	2,3
05.4	Qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës	12,1	107,3	0,4	3,5
05.5	Veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht	9,9	104,3	0,0	1,6
05.6	Mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake	17,1	105,1	0,6	2,2

**Tabela 2: Peshat, IHÇK-it për muajin Janar 2020 (2015=100), ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në përqindje për grupe dhe nëngrupe sipas COICOP-it (vazhdim)**

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2020 në %	I - 2020 2015=100	I - 2020 XII- 2019	I - 2020 I - 2019
<b>06</b>	<b>Shëndetësia</b>	<b>21,4</b>	<b>106,7</b>	<b>2,1</b>	<b>3,8</b>
06.1	Produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje	12,0	105,7	1,5	2,8
06.2	Shërbimet ambulatore	8,4	108,9	3,2	5,6
06.3	Shërbimet spitalore	1,0	100,0	0,0	0,0
<b>07</b>	<b>Transporti</b>	<b>156,9</b>	<b>106,3</b>	<b>-0,2</b>	<b>2,0</b>
07.1	Blerja e automjeteve	57,3	101,7	-0,6	2,0
07.2	Përdorimi i pajisjeve për transportin personal	77,9	109,6	-0,1	2,7
07.3	Shërbimet për transport	21,7	105,7	0,4	0,0
<b>08</b>	<b>Mjetet e komunikimit</b>	<b>37,6</b>	<b>98,8</b>	<b>-0,1</b>	<b>1,0</b>
08.1	Shërbimet postare	2,5	104,6	0,0	0,0
08.2	Pajisjet telefonike dhe të telefaksit	4,1	87,1	-1,2	4,1
08.3	Shërbimet telefonike dhe të telefaksit	31,0	100,6	0,0	0,7
<b>09</b>	<b>Rekracioni dhe kultura</b>	<b>44,0</b>	<b>96,9</b>	<b>-0,1</b>	<b>-0,2</b>
09.1	Pajisjet audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave	11,1	84,4	-0,2	-3,5
09.2	Pajisjet tjera të qëndrueshme për rekreacion dhe kulturë	2,1	101,2	0,0	-0,9
09.3	Gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret	7,5	102,3	-0,3	0,0
09.4	Shërbimet rekreative dhe kulturore	6,4	102,6	0,0	1,8
09.5	Gazetat, librat dhe materialet për zyra	11,1	100,2	0,0	1,7
09.6	Pushime të organizuara	5,8	101,0	0,0	0,4
<b>10</b>	<b>Arsimi</b>	<b>10,4</b>	<b>99,8</b>	<b>0,2</b>	<b>0,2</b>
<b>11</b>	<b>Restorantet dhe hotelet</b>	<b>32,1</b>	<b>107,2</b>	<b>1,2</b>	<b>2,7</b>
11.1	Shërbimet hoteliere	28,5	107,3	1,4	2,3
11.2	Shërbimet për strehim	3,6	108,9	0,0	6,0
<b>12</b>	<b>Mallrat dhe shërbimet e ndryshme</b>	<b>45,3</b>	<b>106,4</b>	<b>0,1</b>	<b>3,5</b>
12.1	Kujdesi personal	16,1	103,0	0,3	0,4
12.3	Gjërat personale	9,5	107,1	0,1	2,9
12.4	Mbrojtja sociale	1,0	108,5	0,0	0,7
12.5	Sigurimet	7,8	122,3	0,0	19,3
12.6	Shërbimet financiare	7,7	101,0	0,0	0,0
12.7	Shërbimet tjera	3,2	99,2	0,0	-0,5

Tabela 3: Çmimi mesatar në euro për disa artikuj dhe shërbime më reprezentuese

Kodi	Artikujt	Njësia matëse	I 2019	XII 2019	I 2020
101	Oriz	1 kg	1,33	1,34	1,33
102	Miell gruri	1 kg	0,47	0,48	0,49
103	Bukë e bardhë	500 gr	0,34	0,35	0,35
111	Mish gjedhi pa eshtra	1 kg	7,10	7,02	6,95
112	Mish viçi	1 kg	7,74	7,95	7,90
114	Mish pule	1 kg	2,67	2,81	2,79
131	Qumësht (Tetrapak)	1 lit	0,91	0,93	0,93
133	Jogurt	1 lit	0,88	0,85	0,87
137	Vezë	30 copë	2,81	2,57	2,53
141	Vaj ushqimor luledielli	1 lit	1,02	1,03	1,03
151	Mollë	1 kg	0,51	0,61	0,62
152	Dardhë	1 kg	1,52	1,62	1,59
153	Banane	1 kg	1,00	1,19	1,19
155	Limon	1 kg	1,18	1,37	1,37
161	Patate	1 kg	0,73	0,39	0,45
162	Domate	1 kg	1,48	0,88	1,52
163	Fasule	1 kg	2,34	2,45	2,46
167	Speca të pa djegës	1 kg	2,33	1,20	1,93
175	Sheqer	1 kg	0,68	0,69	0,69
192	Kafe e bluar	1 kg	8,12	9,59	9,60
193	Çaj	1 kg	7,95	7,70	7,78
195/1	Uji natyral pa gaz	1.5 lit	0,30	0,31	0,31
204	Birrë	0.5 lit	0,65	0,65	0,64
216	Cigare - Ronson	1 pako	1,66	1,68	1,70
217	Cigare - Marlboro	1 pako	2,68	2,70	2,69
416	Energja elektrike (Pa kosto fikse)	1 kwh	0,06	0,06	0,06
418	Dru zjarri	1 m <sup>3</sup>	41,02	38,68	38,96
701	Benzin	1 lit	1,10	1,15	1,15
702	Dizel	1 lit	1,09	1,14	1,14

## Metodologjia e IHÇK

IHÇK të Kosovës, i prodhuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), është i përpiluar sipas metodave të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK). Eurostati e ka definuar IHÇK si standard Evropian për indekset e çmimeve të konsumit. Indeksi i kalkuluar dhe rezultatet e tyre prezantohen përmes *Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit* (COICOP), klasifikim ky ndërkombëtarë i cili klasifikon konsumin në Divizione, Grupe dhe Klasa artikujsh. Sipas COICOP-it, ASK ka ndarë 91 klasa konsumi të definuar (në nivel 4-shifror) më tutje në 418 produkte (agregat elementarë). ASK ka përcaktuar peshë për çdo element agregues dhe çdo muaj grumbullon çmime për secilin agregat elementarë.

Çdo muaj IHÇK kullohet në dy hapa:

1. Indekset elementarë (treguesit për agregat elementarë) llogariten nga çmimet e grumbulluara duke përdorur formulën e mesatares gjeometrike të peshuar ( të *Jevon-it*).
2. Indekset e nivelit më të lartë, dukë përfshirë vetë IHÇK, llogariten dukë nxjerrë mesataren e indekseve elementarë përmes formulës së mesatares aritmetike të peshuar (*tipi i Laspeyres*).

Peshat elementare të agreguara janë bazuar në vlerësimet e shpenzimeve të konsumit vjetor. ASK për 91 klasa konsumi bën vlerësimin e shpenzimeve të konsumit vjetor nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) dhe Llogaritë Kombëtare (LLK), peshat brenda klasave të konsumit vijnë nga burimet e brendshme të ASK-së. Peshat specifike nga janari 2013, ishin të bazuara në vlerësimet e të dhënave të Anketës së Buxhetit Familjar dhe Llogarive Kombëtare që i referohen vitit 2012. Nga janari i vitit 2015 peshat specifike të rifreskauara bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2013. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike për artikuj dhe shërbime të harmonizuara sipas E-coicop (rekomandime nga Eurostatit) bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar të vitit 2014. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2015. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2016. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2017. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare të vitit 2018. Rifreskimi i peshave çdo vit, siguron se IHÇK reflekton trendët aktuale të konsumit.

Të gjitha blerjet monetare të bëra në vend (brenda vendit) nga sektori i ekonomive familjare definojnë si gjithsej shpenzimet e konsumit vjetor. Ky definicion përputhet me kategorinë e LLK të quajtur *Konsumi Final Monetar i Ekonomive Familjare (HFMC)* dhe nënkupton se peshat duhet të përfshijnë vlerën e konsumit të produkteve vetanake dhe koston e banimit nga vetë pronari.

Deri në dhjetorin e vitit 2014 peshat kanë përfshi shpenzimet vetëm për konsumatorët rezident, ndërsa nga janari i vitit 2015 përfshihen edhe shpenzimet për konsumatorët jo rezident.

Për të vlerësuar ndryshimet mujore të çmimeve, stafi i ASK mbledh çmime për një numër të artikujve specifik (shpesh të quajtur *shporta e tregut*) të zgjedhura si përfaqësim i agregateve elementar. Qëllimi është që të mblidhen të gjitha çmimet, pikërisht artikujve të njëjtë për çdo muaj; kurdo që një çmim nuk ka mundësi të mblidhet, atëherë procedurat e llogaritjes duhet të aplikohen me kujdes për t'iu shmangur rezultatit të anueshëm.

Grumbulluesit e të dhënave pranë ASK-së, me seli në shtatë qendra rajonale (zyre rajonale statistikore), mbledhin përafërsisht mbi 6800 çmime gjatë periudhës nga data 10-20 të çdo muaji referues. Çmimet mblidhen në supermarkete, ndërmarrje shërbyese, dyqane, tregje dhe pika tjera të shitjes me pakicë në katërmbëdhjetë komuna të Kosovës:

- Gjakovë
- Gjilan
- Istog
- Mitrovicë
- Pejë
- Kamenicë
- Rahovec
- Podujevë
- Prishtinë
- Prizren
- Suharekë
- Ferizaj
- Vushtrri
- Kaçanik

Stafi i zyrës qendrore të ASK-së në Prishtinë mbledh çmimet për artikuj dhe shërbime si rryma, uji, shërbimet postare dhe telekomunikacioni, për transportin ajror dhe hekurudhor .

### **Indekset Elementar**

Indeksi elementar për një muaj është i barabartë me indeksin e tij në muajin paraprak të shumëzuar me ndryshimin e çmimit të matur për një muaj, i llogaritur nga çmimet e grumbulluara. ASK përdor formulën e mesatares gjeometrike (apo të *Jevon-it*) për të llogaritur ndryshimet njëmuajore: shkalla e mesatares gjeometrike të muajit aktual në mesataren gjeometrike të çmimeve të mbledhura për muajin e kaluar.

Indeksi i agregatit elementar  $e$  për muajin  $m$

$$I_e^m = I_e^{m-1} \times \left[ \left( \prod_{i=1}^{n_e} p_i^m \right)^{1/n_e} / \left( \prod_{i=1}^{n_e} p_i^{m-1} \right)^{1/n_e} \right] \quad I_e^0 \equiv 100$$

$I_e^m$  = Indeksi i çmimit për agregatin elementar  $e$  për muajin  $m$

$I_e^{m-1}$  = Indeksi i çmimit për agregatin elementar  $e$  për muajin  $m-1$

$p_i^m$  = Çmimi për artikullin  $i$  në muajin  $m$

$p_i^{m-1}$  = Çmimi për artikullin  $i$  në muajin  $m-1$

$n_e$  = Numri i çmimeve të mbledhura për agregatin elementar  $e$

### **Indekset e Nivelit më të Lartë**

Në Kosovë, Indekset e IHÇK së pari llogariten në grupe (të agregateve elementare) dhe pastaj këto kombinohen për të nxjerrë IHÇK e tërësishëm.

Indekset e Nivelit të Lartë peshohen me mesataret aritmetike të indekseve elementare. Në IÇK është përdor formula e *Young*-ut deri në dhjetor 2013, peshat janë pjesë e peshimit të parregulluar për shpenzime në periudhë. Që nga janari 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së *Lowe-it* për kalkulimin e indeksit, me pesha të cilat janë pjesë e peshave të periudhave të shpenzimeve, e të cilat janë të azhuruara me ndryshimet e çmimeve. (Formula e *Lowe-it* është e përafërt me formulat aktuale të *Laspeyres*).

Të dy formulat, si formula e *Young*-ut dhe ajo e *Lowe-it* janë mesatare aritmetike të peshuara me pesha që janë pjesë e shpenzimeve të konsumit, dhe të dyja janë lloj i formulave të indeksit të *Laspeyres*. Aktualisht IHÇK përdor formulën e *Lowe-it* për indekse, peshat e të cilit janë pjesë e shpenzimeve gjatë periudhës së peshuar viti 2010. Peshat e reja nga të dhënat e LLK dhe ABF- vitit 2012 janë aplikuar nga janari i vitit 2014. IÇK ka kaluar në kalkulimin e indekseve me formulën *Lowe-it*; (peshat kanë qenë pjesë e shpenzimeve të vitit 2012 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2013. Nga janari i vitit 2015 janë aplikuar peshat specike nga të dhënat e LLK dhe ABF të vitit 2013 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2014. Nga janari i vitit 2016 peshat specifike bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) dhe nga Anketa e Buxhetit Familjar (ABF) të vitit 2014 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2015. Nga janari i vitit 2017 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2015 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2016. Nga janari i vitit 2018 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2016 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2017. Nga janari i vitit 2019 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2017 të kalkuluar me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2018. Nga janari i vitit 2020 peshat specifike për artikuj dhe shërbime bazohen

në të dhënat e Llogarive Kombëtare (LLK) të vitit 2018 të kalkuluara me ndryshimet e çmimeve të dhjetor të vitit 2019.

### ***Peshat e Indeksit***

#### **Formula e Young** Peshon Agregatet Elementare brenda Grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b}{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementarë  $e$  brenda grupit  $g$  në periudhën peshuese  $b$

$x_e^b$  = shpenzimet për agregatin elementar  $e$  në periudhën peshuese  $b$  (Aktualisht  $b = 2012$ )

$k_g$  = Numri i agregateve elementare në grupin  $g$

#### **Formula e Young** peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} x_e^b}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} x_e^b} \quad \sum_{g=1}^h w_g^b = 1$$

$w_g^b$  = Pesha për grupin  $g$  në periudhën peshuese  $b$

$h$  = Numri i grupeve në ICK

#### **Formula e Lowe-it** peshon agregatet elementarë brenda grupeve

$$w_{e,g}^b = \frac{x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v}}{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b = 1$$

$w_{e,g}^b$  = Pesha për agregat elementar  $e$  brenda grupit  $g$  në periudhën peshuese  $b$   
(Në përdorim nga Janari 2014,  $b = 2012$ )

$a_e^{b \rightarrow v}$  = faktor rregullues i peshave për agregatet elementar  $e$

$$a_e^{b \rightarrow v} = I_e^v / \frac{1}{12} \left( \sum_{m=Jan}^{Dec} I_e^{m/b} \right)$$

$I_e^v$  = Indeksi i çmimit për agregate elementar  $e$  për muajin  $v$

(Në përdorim nga Janari 2014,  $v =$  Dhjetor 2013)

$I_e^{m/b}$  = Indeksi i çmimeve për agregat elementarë  $e$  në muajin  $m$  në vitin  $b$

**Formula e Lowe** peshon grupet brenda IHÇK së tërësishëm

$$w_g^b = \frac{\sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})}{\sum_{g=1}^h \sum_{e=1}^{k_g} (x_e^b \times a_e^{b \rightarrow v})} \quad \sum_{g=1}^h w_{e,g} = 1$$

**Indekset për Grupet e niveleve më të larta**

$$I_g^m = \sum_{e=1}^{k_g} w_{e,g}^b * I_e^m \quad I_e^0 = 100$$

Për shumicën e artikujve periudha 0 është Maj 2002 ,  
por kjo periudhë ndryshon për sipas inkuadrimit të artikujve të përfshirë më vonë

***IHÇK i tërësishëm***

IHÇK i tërësishëm është një mesatare aritmetike e peshuar e indekseve të grupeve. Në IHÇK është përdor formula e *Young-it*, por që nga Janari i vitit 2014 është kaluar në përdorimin e formulës së *Lowe-it*.

Për shkak se nëngrupet kanë baza të ndryshme indeksesh (shumica kanë për bazë Maj 2002=100, por grupet e shtuara më vonë kanë bazë tjetër, nga janari i vitit 2016 idenkset janë të kalkulura me vitin bazë 2015=100), indekset e grupeve duhet të ribazohen në një periudhë të përbashkët, që është muaji *v* (muaji paraprak para së të vihen në përdorim peshat e reja).

$$HICP^m = HICP^v \times \sum_{\xi=1}^h w_{\xi}^b \times \frac{I_{\xi}^m}{I_{\xi}^v} \quad HICP^0 = 100$$

$HICP^m$  = Indeksi i harmonizuar i çmimit të konsumit për muajin *m*

*v* = muaji paraprak para së të përdoren peshat e reja (Aktualisht *v* = Dhjetor 2018)



# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj**

Të punësuar janë gjithsej 159 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informatat të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-qov.net](mailto:infoask@rks-qov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>